

Nr.	Drejtoria/Struktura	Detyrat funksionale	Arsimi dhe kualifikimet e drejtorëve/CV
1.	DREJTORI I DSIK	<p>Formulimi i politikave për sigurimin e informacionit të klasifikuar dhe kontrolli i tyre nga institucionet;</p> <p>Përcaktimi i objektivave dhe formulimi i programeve, standardeve dhe procedurave përkatëse për zbatim;</p> <p>Sigurimi i përdorimit eficient të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave;</p> <p>Planifikimi dhe drejtimi i veprimtarisë së përditshme administrative të institucionit etj.</p>	Drejtori (CV)
2.	DREJTORIA E VETTING-ut & SIGURIMIT INDUSTRIAL 1. Drejtori 2. Shefat e Sektorëve 3. Specialistët	<p>Propozimi dhe hartimi i politikave, procedurave, inspektimeve dhe mbikëqyrjes së institucioneve shtetërore dhe kontraktorëve në fushën e sigurimit të personelit dhe të sigurimit industrial, për informacionin e klasifikuar, të NATO-s, të BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare</p>	Drejtori (CV)
3.	DREJTORIA E SIGURIMIT, ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTAVE DHE REGJISTRIT QENDROR 1. Drejtori 2. Shefat e Sektorëve 3. Specialistët	<p>Përcaktimi i parimeve që lidhen me krijimin, klasifikimin, rivlerësimin, regjistrimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, arkivimin, transportimin fizik, sigurimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar dhe kontrollon zbatimin e tyre prej institucioneve.</p> <p>Kontrolli e zbatimi i legjislacionit dhe procedurave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të NATO-s.</p>	Drejtori (CV)

4.	DREJTORIA E FINANCËS, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE MBIKËQYRJES SHTETËRORE 1. Drejtori 2. Shefat e Sektorëve 3. Specialistët	Kryerja e veprimtarisë ekonomike, financiare, administrative, teknike dhe në fushën e personelit. Mbikëqyrja e zbatimi i legjislacionit për informacionin e klasifikuar nga institucionet shtetërore.	Drejtori (CV)
5.	SEKTORI I SIGURIMIT TË SISTEMEVE TË KOMUNIKIMIT DHE INFORMACIONIT 1. Shefi i Sektorit 2. Specialisti	Propozimi e hartimi i politikave, ndjekja e procedurave, inspektimi dhe mbikëqyrja e institucioneve shtetërore dhe kontraktorëve në fushën e sigurimit të sistemeve të komunikimit dhe informacionit, për informacionin e klasifikuar, të NATO-s, të BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.	Shefi i Sektorit (CV)
6.	SEKTORI PËR KONTROLLIN E FIGURËS 1. Shefi I Sektorit 2. Specialistët	Drejtimin e procesit për kontrollin e figurës, sipas përcaktimit në ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	Shefi i Sektorit